

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6513
E mërkurë, 19 janar 2022
çmimi 0.40 €

Roberta Metsola zgjedhet
presidente e Parlamentit
Evropian | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA E KOSOVËS KA ZOTUAR 75 MILIONË EURO PËR SUBVENCIONIMIN
E ENERGJISË PËR QYTETARËT DHE BIZNESET | FAQE 4-5

SHTRENJTOHET ENERGJIA ELEKTRIKE, PARALAJMËROHEN PROTESTA



Qeveria ka pranuar propozimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRrE) për rivendosjen e bllok tarifës deri në 600 KWh për konsumatorët e amvisërisë si dhe që tarifën e energjisë elektrike të ngritën për 9 për qind për të gjithë konsumatorët komercialë dhe konsumatorët e amvisërisë që konsumojnë deri në 600 KWh. Sipas propozimit, tarifën për konsumin e amvisërisë mbi 600 KWh do të reflektonin çmimin e importit. Qeveria ka zotuar 75 milionë euro për subvencionimin e energjisë elektrike për qytetarët dhe bizneset. Opozita ka kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe ka paralajmëruar protesta

AKTUALE



AMBASADORI I RI I SHBA-së
PREMTON MBËSHTETJE PËR
SEKTORIN E SHËNDETËSISË | F. 7

KRYETARËT E KOMUNAVE
KUNDËRSHTOJNË PROJEKTLIGJIN
PËR INSPEKTIMIN ADMINISTRATIV | F. 5

LATIFI, TAKIM ME DREJTORËT E
SHKOLLAVE: BUXHETIN PËR
SHKOLLAT TA SHPENZONI ME KOHË | F. 6

EKONOMI



ODA E HOTELERISË DHE TURIZMIT
PO MERR PJESË NË PANAIRIN E
ORGANIZUAR NË ANTALI | F. 8

GJERMANIA JEP 12.65 MILIONË
EURO PËR NGROHJEN QENDRORE
TË TERMOKOSIT ME ENERGJI
SOLARE | F. 8

SPORT



PRISHTINA VAZHDON PËRGATITJET
NË TURQI, KONFIRMON NDARJEN
ME BEKTESHIN | F. 11

Kosova regjistron një
viktimë dhe 720 raste
të reja me Covid | FAQE 7



DNV-ja VLERËSON SE ËSHTË
KOHA IDEALE PËR INICIMIN E
REFORMËS ZGJEDHORE

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Roberta Metsola zgjedhet presidente e Parlamentit Evropian

BRUKSEL, 18 JANAR - Roberta Metsola, një politikane kristiano-demokrate nga Malta, u zgjodh presidente e Parlamentit Evropian me një mandat prej dy vjet e gjysmë. Ajo në këtë pozitë vjen pasi javën e kaluar vdiq David Sassoli.

Metsola është gruaja e tretë që është

zgjedhur në këtë pozitë. Ligjvënësja malteze, 43-vjeçare, u bë presidentja më e re e zgjedhur e PE-së.

Sassoli, 65 vjeç, që vdiq javën e kaluar, kishte qenë i sëmurë muajt e fundit dhe kishte thënë se nuk dëshironte të kandidonte për një mandat të ri.

Metsola gjatë votimit të së martës fitoi 458 vota nga 616 deputetë që morën pjesë në votim.

Që prej vdekjes së Sassolit, Metsola ka qenë ushtruese e detyrës e presidentit të PE-së. Ajo tha se dëshiron që ta vazhdojë stilin e punës së Sassolit. "Davidi luftoi fort

për t'i ulur njerëzit në një tavolinë. Është zotimi për t'i mbajtur së bashku forcat konstruktive në Evropë që unë do të punoj", tha ajo. Parlamenti Evropian vitet e fundit është bërë institucion edhe më i fuqishëm brenda bllokut evropian. PE-ja përfaqëson 450 milionë



banorët e BE-së dhe e quan veten "zemër të demokracisë evropiane".

Britania e furnizon me armë Ukrainën që të mbrohet nga Rusia



LONDËR, 18 JANAR - Britania po e furnizon Ukrainën me pako të reja të sistemeve të sigurisë për ta ndihmuar që t'i rrisë kapacitetet mbrojtëse teksa ky shtet përballet me sjellje kërcënuese nga Rusia, tha sekretari i Mbrojtjes, Ben Wallace. "Ne kemi marrë vendimin që ta furnizojmë Ukrainën me sisteme të lehta të armëve mbrojtëse anti-blindë", tha Wallace para parlamentit britanik.

Ai shtoi se e ka ftuar homologun rus që në javët në vijim ta vizitojë Londrën për të diskutuar lidhur me krizën me Ukrainën. "Këto nuk janë armë strategjike dhe nuk

paraqesin kërcënim për Rusinë. Ato përdoren për vetëmbrojtje", tha ai.

Kievi dhe Perëndimi janë të shqetësuar pas grumbullimit të mijëra trupave ruse përgjatë kufirit me Ukrainën. Perëndimi ka thënë se Rusia mund të jetë duke u përgatitur për një pushtim të mundshëm të Ukrainës, por Moska thotë se nuk ka plane për ta sulmuar Ukrainën.

Javën e kaluar shtetet perëndimore dhe NATO u takuan me zyrtarë rusë dhe biseduan për çështjen e grumbullimit të trupave ruse, por këto bisedime nuk nxorën ndonjë rezultat konkret.

Presidenti rus do të takojë homologun e tij iranian në Moskë

MOSKË, 18 JANAR - Kremli ka thënë se presidenti rus Vladimir Putin do të takohet me homologun iranian Ebrahim Raisi më 19 janar në Moskë, ndërkohë që zhvillohen negociatat për ringjallje të marrëveshjes bërthamore, të cilën Teherani e ka nënshkruar me fuqitë botërore më 2015.

Kjo do ta shënojë vizitën e tretë të Raisit jashtë Iranit pas Tashkistanit dhe shtetit fqinj Turkmenistanit, prej kur ai ka marrë pushtetin në gusht të vitit 2021.

Ky njëherësh shënon edhe takimin e parë të një presidenti iranian në Rusi prej vitit 2017. Moska dhe Teherani kanë lidhje të forta politike, ekonomike dhe ushtarake dhe janë aleatë të presidentit sirian

Bashar al-Assad në shtetin e tij të shkatërruar nga lufta.

Putini dhe Raisi do të diskutojnë "një mori çështjesh në kuadër të bashkëpunimit bilateral" duke përfshirë marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 që parashihet heqjen e sanksioneve të Perëndimit, në këmbim të kufizimit të programit bërthamor të Teheranit, është thënë në deklaratën e Kremlin.

Pala iraniene ka thënë se Raisi do të niset më 19 janar për një udhëtim dyditor në Rusi, bashkë me ministrat për naftë, ekonomi dhe punë të jashtme.

Marrëveshja bërthamore ka nisur të mos zbatohet prej kur ish-presidenti amerikan Donald

Trump ka tërhequr njëanshëm Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja dhe ka rikthyer sanksionet, duke shtyrë Teheranin që ta shkelë paktin.

Prej vitit të kaluar Irani është duke zhvilluar negociatat me shtetet e tjera nënshkruese të marrëveshjes; Britaninë, Francën, Rusinë, Kinën, Gjermaninë - dhe ShBA-në në mënyrë indirekte, për ta ringjallur marrëveshjen, mirëpo negociatat janë pezulluar për gati pesë muaj, në kohën kur Irani ka mbajtur zgjedhjet presidenciale. Një ndër çështjet kyçe të bisedimeve është edhe ajo e rikthimit të ShBA-së në marrëveshje dhe heqje të sanksioneve, në mënyrë që Irani ta zbatojë këtë pakt plotësisht.




Çekia regjistron rritje të rasteve me Covid-19

PRAGË, 18 JANAR - Republika Çeke raportoi të martën për mbi 20 000 raste të reja me koronavirus. Kjo është shifra më e lartë e infektiveve ditore që dy shtet ka regjistruar që prej 1 dhjetorit të vitit 2021, tha Ministria e Shëndetësisë e Çekisë.

Republika çeke, shtet me 10.7 milionë banorë, po përballet

me një valë të re të pandemisë, teksa varianti Omicron i koronavirusit ka nisur që ta rrisë numrin e të infektuarve. Qeveria çeke ka shkurtuar periudhën e karantinës dhe izolimit si pjesë e masave të reja. Megjithatë, autoritetet çeke e kanë bërë të detyrueshme testimin e punëtorëve të kompanive, masë kjo që hyri në

fuqi këtë javë. Ministria e Shëndetësisë së Çekisë njoftoi se në 24 orët e fundit ka regjistruar 20 270 raste të reja, që është rritje e lartë krahasuar me 7 342 raste që ishin regjistruar një javë më parë. Ndërkaq, numri i qytetarëve të hospitalizuar që në dhjetor kishin qenë 7 000, të hënën ishin 1 660.



DnV-ja vlerëson se është koha ideale për inicimin e reformës zgjedhore

Demokracia në Veprim (DnV) ka theksuar se meqenëse vendi nuk do të ketë cikël të rregullt zgjedhor për tri vjet, konsideron se tash është koha ideale për inicimin e diskutimeve për fillimin e një procesi përmbajtësor të reformës zgjedhore, duke rishikuar në tërësi legjislacionin zgjedhor

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 JANAR - Demokracia në Veprim (DnV) ka theksuar se Kosova tanimë ka kaluar më shumë se një dekadë që nga inicimi i reformës zgjedhore, proces ky i cili nuk është përmbyllur në mungesë të një përkushtimi dhe vullneti politik. Madje edhe iniciativa e vitit 2019 për përmirësimin dhe fuqizimin e procesit zgjedhor nëpërmjet formimit të një komisioni ad-hoc në Kuvendin e Kosovës, që kishte mbetur në gjysmë për shkak të shkuarjes në zgjedhje të parakohshme parlamentare, nuk është iniciuar më. "Vitin që lamë pas Kosova përmbylli me sukses dy procese zgjedhore, të nivelit qendror dhe atij lokal, zgjedhje të cilat sërish u shoqëruan nga disa probleme të përsëritura ndër vite. Këto probleme burojnë kryesisht nga sistemi zgjedhor dhe elementet teknike të tij, të cilat janë hartuar në

një kontekst të ndryshëm politik", ka njoftuar DnV-ja.

Demokracia në Veprim ka theksuar se meqenëse vendi nuk do të ketë cikël të rregullt zgjedhor për rreth edhe tri vjet, konsideron se tash është koha ideale për inicimin e diskutimeve për fillimin e një procesi përmbajtësor të reformës zgjedhore, duke rishikuar në tërësi legjislacionin zgjedhor. "Draftimi i një kodi zgjedhor, i cili do t'i përfshinte të gjitha aspektet e çështjeve zgjedhore, duhet të merret seriozisht në konsideratë si mënyrë e shpërfaqjes së vendosmërisë për ta shtyrë përpara reformën zgjedhore", është thënë në njoftimin e kësaj organizate.

DnV-ja ka vlerësuar se ky proces, i cili është i një rëndësie shumë të madhe për vendin, duhet të jetë i bazuar në parime dhe vlera të cilat garantojnë zbatueshmëri të tij në praktikë dhe reflektojnë pajtueshmëri të gjerë të publikut. DnV-ja ka theksuar se vlerat dhe parimet themelore mbi të cilat

duhet të iniciohet dhe të zhvillohet reforma zgjedhore janë: Përcaktimi i objektivave dhe subjekteve të reformës zgjedhore. "Objektivat e reformimit të sistemit zgjedhor duhet të përcaktohen qartazi para inicimit të procedurave zyrtare. Kjo nënkupton që duhet të definohen qëllimi përfundimtar që synohet të arrihet me reformën zgjedhore si dhe çështjet që do të trajtohen, duke mos anashkaluar edhe elementet e sistemit politik, përfshirë partitë politike dhe financimin e tyre, si dhe funksionimin e medieve gjatë zgjedhjeve. Të gjitha ndryshimet eventuale duhet të jenë në përputhje me pesë parimet evropiane të zgjedhjeve, që përfshijnë votimin universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë", thuhet në vlerësimin e DnV-së.

DnV-ja ka shtuar se aktorët e përfshirë në proces nuk duhet ta paralizojnë reformën zgjedhore në atë mënyrë që të adresohen apo ndryshohen vetëm segmente të caktuara të sistemit të cilat i konvenojnë njëres apo palës tjetër. "Sa iu përket subjekteve të reformës zgjedhore, meqë Kosova është republikë parlamentare, iniciativa duhet të burojë nga Kuvendi i Kosovës, eventualisht nga partia në pushtet e cila ka shumicën në Kuvend. Kuvendi do të duhej të themelonte një

komision të posaçëm, përbërja e të cilit reflekton kompozicionin politik të Kuvendit, por i cili do të duhej të kryesohej nga opozita, si vlerë e shtuar e procesit", është bërë me dije në këtë njoftim.

DnV-ja ka vlerësuar se duhet edhe konsensusi politik dhe shoqëror. "Duke qenë se sistemi zgjedhor është në esencë përkthim i vullnetit politik të qytetarëve, do të duhej që reforma zgjedhore të reflektojë një konsensus sa më të gjerë shoqëror i cili përkthehet edhe në konsensus politik. Po ashtu, në funksion të arritjes së një konsensusi sa më të gjerë, duhet që të ketë dakordim edhe për shumicën e nevojshme dhe mënyrën e votimit të ndryshimeve eventuale, e cila duhet të garantojë respektim të qëndrimit të të gjitha palëve dhe mosbllokim të procesit, për aq sa është e mundur", ka theksuar DnV-ja.

Kjo organizatë ka njoftuar se votimi me 2/3 e votave në Kuvend, sidomos duke ditur se disa prej reformave mund të kërkojnë ndryshime kushtetuese, do të duhej të ishte kriter minimal. Sipas DnV-së, reforma zgjedhore dhe raportet mes partive politike për këtë çështje duhet të zhvillohen nën besim reciprok. Po ashtu, DnV-ja ka theksuar se në kuadër të kësaj reforme duhet të ketë gjithëpërfshirje, transparencë dhe llogaridhënie. "Në kuadër të

iniciativës së reformës zgjedhore duhet të përfshihen të gjithë aktorët e interesuar për të kontribuar në proces, duke përfshirë nivelin politik, administrativ dhe sektorin joqeveritar. Në këtë drejtim, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve të tjera që kanë përgjegjësi të çfarëdollojshme në zgjedhje dhe palët e interesit duhet të ofrohet mundësi për përfshirje në kuadër të grupeve punuese", është thënë në njoftimin e DnV-së, duke shtuar se pjesë e kësaj reforme është edhe proporcionaliteti kohor. "Procesi i reformës zgjedhore nuk duhet të marrë edhe një dekadë tjetër për t'u përmbyllur. Ndryshimet eventuale që mund të bëhen me nguti dhe në afate të ngushta kohore mund ta cenojnë konsensusin politik dhe transparencën ndaj qytetarëve, duke e dëmtuar procesin në tërësi. Meqenëse Kosova nuk do të ketë vit zgjedhor të rregullt edhe rreth tri vjet (deri në vitin 2025), duhet që procesi i reformës të zhvillohet brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në atë mënyrë që garanton respektimin e parimit që ndryshimet duhet të miratohen të paktën një vit para zgjedhjeve, me qëllim që institucionet përkatëse të kenë kohë të mjaftueshme për implementim të ndryshimeve dhe informim të qytetarëve", ka vlerësuar Demokracia në Veprim.





QEVERIA E KOSOVËS KA ZOTUAR 75 MILIONË EURO PËR SUBVENCIONIMIN E ENERGJISË PËR QYTETARËT DHE BIZNESET

Shtrenjtohet energjia elektrike, paralajmërohen protesta

Qeveria ka pranuar propozimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) për rivendosjen e bllok tarifës deri në 600 KWh për konsumatorët e amvisërisë si dhe që tarifën e energjisë elektrike të ngritën për 9 për qind për të gjithë konsumatorët komercialë dhe konsumatorët e amvisërisë që konsumojnë deri në 600 KWh. Sipas propozimit, tarifën për konsumin e amvisërisë mbi 600 KWh do të reflektonin çmimin e importit. Qeveria ka zotuar 75 milionë euro për subvencionimin e energjisë elektrike për qytetarët dhe bizneset. Opozita ka kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe ka paralajmëruar protesta

në koston e energjisë. ZRRë-ja ka propozuar rivendosjen e bllok tarifës deri në 600 KWh për konsumatorët e amvisërisë, si dhe që tarifën e energjisë elektrike të ngritën për 9 për qind për të gjithë konsumatorët komercialë dhe konsumatorët e amvisërisë që konsumojnë deri në 600 KWh, ndërsa tarifën për konsumin e amvisërisë mbi 600 KWh do të reflektonin çmimin e importit, është thënë në njoftimin e Ministrisë së Ekonomisë.

Sipas njoftimit të qeverisë, subvencionimi do t'i mbrojtë qytetarët nga rritja e çmimit. "Duke marrë parasysh situatën e jashtëzakonshme dhe të paprecedentë në tregjet evropiane të energjisë elektrike që ka ndikuar edhe në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë është zotuar t'i subvencionojë qytetarët e bizneset e Kosovës, duke i mbrojtur kështu nga rritja e tarifave. Subvencionet paraqesin të ardhura për sektorin që nuk është e nevojshme të mbulojnë nga

tarifat e energjisë elektrike dhe, rrjedhimisht, zbusin rritjen e tarifës së energjisë elektrike. Subvencioni i energjisë elektrike nga ana e qeverisë do të ndikojë që tarifa për konsumatorët biznesorë mbetet me 0 për qind rritje, tarifa për konsumatorët shtëpiakë deri në konsumin prej 600 KWh mbetet me 0 për qind rritje, ndërsa tarifa e propozuar nga ZRRë për konsumatorët shtëpiakë për konsumin mbi 600 KWh të reduktohet, duke pasqyruar çmimin e importit për këta konsumatorë dhe promovuar eficiencën e energjisë", është thënë në njoftimin për medie. Gjatë kësaj kohe të jashtëzakonshme, sipas Ministrisë së Ekonomisë, qëllimi primar i subvencionit të ndarë nga Qeveria e Kosovës është për t'i mbrojtur veçanërisht konsumatorët e ndjeshëm nga ndikimi i çmimeve më të larta të energjisë elektrike.

energjisë elektrike. Për ngritjen e çmimit ato kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës. Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, ka thënë se rritja e çmimit të energjisë elektrike do ta godasë rëndë xhepin e qytetarëve.

Në një konferencë për medie ai ka thënë se paralajmërimet e kësaj partie ndaj qeverisë për të ndërmarrë hapa adekuatë për zgjidhjen e problemeve me kohë tani janë bërë realitet. "Propozimi për rritjen e tarifave të energjisë pas një periudhe të rëndë ekonomike si rezultat i pandemisë, e cila po vazhdon të jetë e tillë, madje edhe më e rënduar, është një nga goditjet më të ashpra që po u bëhet qytetarëve të vendit tonë sot, të cilët, fatkeqësisht dhe padrejtësisht, do të përballen me pasojat e shtrenjtimit më të madh të rrymës në historinë e Kosovës. Kjo rritje do të rëndojë edhe më shumë mirëqenien sociale të qytetarëve dhe pabarazinë sociale, veçanërisht në kohën kur edhe ashtu të gjitha çmimet e produkteve

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 JANAR - Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) për rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

ZRRë-ja ka propozuar rivendosjen e bllok tarifës deri në 600 KWh për konsumatorët e amvisërisë si dhe që tarifën e energjisë elektrike të ngritën për 9 për qind për të gjithë konsumatorët komercialë dhe konsumatorët e amvisërisë që konsumojnë deri në 600 KWh.

Sipas propozimit, tarifën për konsumin e amvisërisë mbi 600 KWh do të reflektonin çmimin e importit. "Kjo ka ardhur si rrjedhojë e tremujorit të fundit të vitit 2021, kur Kosova është dashur të importojë energji elektrike për t'i furnizuar konsumatorët me energji elektrike mbi nivelin që mund të sigurohet nga kapaciteti gjenerues vendor dhe për ta plotësuar rritjen e kërkesës si pasojë e motit të ftohtë. Kostoja e furnizimit me energji elektrike nga importet është ngritur ndjeshëm, duke ndikuar edhe

Opozita kundërshton shtrenjtimitin e rrymës

Partitë opozitare kanë kundërshtuar shtrenjtimitin e

Kryetarët e komunave kundërshtojnë Projektligjin për inspektimin administrativ

PRISHTINË, 18 JANAR - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka mbajtur takimin e Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Kosovës. Në këtë takim kryetarët e komunave kanë diskutuar lidhur me Projektligjin për Inspektimin Administrativ, problemet e komunave me zbatimin e Kontratës Kolektive në Arsim dhe Shëndetësi, problemet me mosfunksionimin e Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, çështjen e Fondit Rezervë si dhe bashkëpunimin

mes nivelit lokal dhe atij qendror në Kosovë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Imri Ahmeti, i cili i ka informuar kryetarët e komunave se si pushteti lokal nuk ka qenë i njoftuar dhe as i përfshirë në procesin e hartimit të Projektligjit për Inspektim Administrativ. Ahmeti ka shtuar se në këtë projektligj që prek administratën shtetërore në nivelin qendror dhe lokal ka

dyfishim të institucioneve që mbulojnë këtë fushë, por edhe interferim në gjashtë ligje ekzistuese si: Ligji për Zyrtarët Publikë, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji për Organizimin e Punës në Zyrë, Ligji për Organizimin e Administratës Shtetërore, Ligji mbi Arkivat Shtetërore dhe Ligji për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës. Po në takim kanë diskutuar edhe kryetarët e komunave që ishin në këtë takim, e ku njëzëri u

deklaruan kundër këtij projektligji.

Kryetarët e komunave në fund u pajtuan me këto konkluzione: "1. Kryetarët e komunave kërkojnë të ndërpritet procedimi i mëtejshëm i Projektligjit për Inspektimin Administrativ; 2. Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkon të jetë partner i Qeverisë së Kosovës gjatë procesit të hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore që prekin qeverisjen lokale; 3. Ky projektligj ndërhyrë edhe në ligjet e tjera që

janë në zbatim në Kosovë; 4. Vlerësohet se ky projektligj po cenon funksionimin e demokracisë lokale në Kosovë; 5. Ky Projektligj në formën e tillë vlerësohet se ndërhyrë edhe në sistemin gjyqësor e prokurorial si dhe shkel parimet e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës; 6. Ky Projektligj është në kundërshtim edhe me Kartën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale", ka njoftuar Asociacioni i Komunave të Kosovës.



primare të konsumit janë rritur dhe kjo rritje do të vazhdojë me efekte zinxhirore edhe më të mëdha", ka thënë Staviceli. Sipas tij, rritja e çmimit të energjisë diskriminon drejtpërdrejt konsumatorët të cilët energjinë elektrike e kanë si burim të vetëm të ngrohjes. "Përmes kthimit të blloktarifa po tentohet të zhvendoset piku i konsumit dhe të stimulohet kursimi, në të njëjtën kohë kjo rritje po përcillet me një diskriminim të drejtpërdrejtë për konsumatorët të cilët energjinë elektrike e kanë si burim të vetëm të ngrohjes, në anën tjetër nuk po shohim asnjë masë të mbështetjes së mirëfilltë nga qeveria qoftë me ofrimin e burimeve alternative qoftë me eficientë e energjisë", ka deklaruar ai.

Edhe deputeti i LDK-së, Besian Mustafa, ka fajësuar Qeverinë e

Kosovës për shtrenjtimin e energjisë elektrike.

Në një konferencë për medie ai ka thënë se mungesa e profesionalizmit, përgjegjësisë dhe vullnetit për punë të qeverisë do ta rëndojë kuletën e qytetarit duke rritur çmimin e faturës së energjisë elektrike për 42 për qind. "Qeveria zgjodhi populizmin e linçimin në kohë zgjedhesh lokale për të fituar ndonjë votë. Paaftësia e qeverisë për ta menaxhuar furnizimin me energji elektrike i ka kushtuar 20 milionë euro të ndara për KOSTT-in, 20 milionë euro për importin e energjisë, dhe 75 milionë euro për subvencionimin e energjisë", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se me shtrenjtimin e energjisë elektrike dëmtohet edhe prodhimi vendor. "Shtrenjtimi i energjisë dëmton

edhe prodhimin vendor. Mosveprimet e qeverisë do ta dëmtojnë rëndë ekonominë, prodhimin vendor dhe vendet e punës. Secila familje do ta marrë faturën 42 për qind më shtrenjtë. Cilat janë planet pas tejkalimit të krizës. Çfarë do të ndodhë gjatë pesë vjetëve të ardhshme. Qeveria nuk ka dhënë se ka kode për ta zgjidhur këtë problem. LDK-ja do të angazhohet që të rriten kapacitetet prodhuese të energjisë dhe fatura të jetë e përbalueshme për secilën familje në Kosovë", ka deklaruar Mustafa. Edhe kryesia e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka diskutuar për situatën aktuale me energji elektrike në vend. Kryesia e AAK-së ka vlerësuar se rritja e çmimeve në këtë kohë është e patolerueshme. "Përderisa veriu i vendit nuk paguan fare për energjinë, është e padrejtë rritja

enorme e çmimeve për pjesën tjetër të qytetarëve, ku goditën amvisëritë dhe bizneset. Gjithashtu, kryesia kërkoi që të shqyrtohet mundësia e organizimit të protestave për ta kundërshtuar shtrenjtimin e paralajmëruar të rrymës elektrike", ka njoftuar AAK-ja. Edhe kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka vlerësuar se rikthimi i sistemit të blloktarifave godet shumicën e konsumatorëve. "Kjo rritje parashihet të ndodhë për të gjithë konsumatorët që harxhojnë më shumë se 600KWh. Rritja e çmimit do të jetë ndërmjet 80 për qind - 100 për qind. Në shoqërinë tonë ngrohja me rrymë ka shumë pak alternativa. Shtrenjtimi i çmimit do të përfshijë shumë familje. Nëse KEK-u ka bërë ndonjë investim në gjeneratorë, ka sens rritja e çmimit. Por, sipas

raportëve të fundit financiare të KEK-ut, kjo korporatë ka pasur fitim vjetor mbi 20 milionë euro, që i bie se çmimi i gjenerimit është më i lartë sesa që paguajmë ne. Kalkulimi i çmimit të energjisë bëhet duke e llogaritur koston e prodhimit, që në Kosovë nuk ka pasur ndonjë ndryshim, duke llogaritur investimet në distribuim, që në Kosovë nuk janë duke u bërë as ato për të cilat ne tashmë kemi paguar", ka shkruar Molliqaj në profilin e vet në "Facebook".

Edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka reaguar ndaj rritjes së çmimit të energjisë. Në reagimin e tyre është thënë se qeverisa është ngutur kur është pajtuar me rritjen e çmimit. Zyra e Rregullatorit për Energji ka treguar se shtrenjtimi i energjisë do të fillojë nga 1 shkurti.

Kryetari i Malishevës pret përkrahjen e qeverisë

MALISHEVË, 18 JANAR - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka pritur të martën në takim ministrin e Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, me të cilin ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit konkret në mes të komunës së Malishevës dhe dikasterit

qeveritar që ai drejton. “Ne kemi nevojë për investime dhe përkrahje qeveritare dhe për këtë, si kryetar i Malishevës, do të jem i hapur e bashkëpunues me të gjithë, në funksion të realizimit të projekteve me interes për qytetarët tanë dhe komunën tonë”, ka thënë Kastrati. Ai ka

shtuar se ministrin Damka e ka falënderuar për vizitën dhe i ka shprehur gatishmërinë e komunës që drejton për të qenë bashkëpunues. “Ramë dakord që këtë frymë të mirë komunikimi ta vazhdojmë edhe në të ardhmen”, ka thënë Kastrati.



Latifi, takim me drejtorët e shkollave: Buxhetin për shkollat ta shpenzoni me kohë

RAHOVEC, 18 JANAR - Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, kryetari i komunës, Smajl Latifi dhe drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Avni Morina, kanë mbajtur të martën takim me drejtorë të shkollave, koordinatore të cilësisë dhe këshillin e prindërve nëpër shkolla.

Avni Morina, drejtor i DKA-së, ka theksuar se ky është takimi i parë për këtë vit ndërkaq, sipas tij, takime të ngjashme do të ketë në vazhdimësi dhe se në këto takime do të diskutohet më hollësisht për mbarëvajtjen e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës.

Kurse Smajl Latifi, kryetar i komunës, u tha drejtorëve të shkollave, koordinatorëve të cilësisë dhe këshillit të prindërve nëpër shkolla, se në rend të parë

është respektimi i ligjeve, udhëzimeve administrative që rregullojnë procesin arsimor dhe masat që janë në fuqi për mbrojtje nga pandemia Covid-19. “Kërkoj nga të gjithë ju që, përveç respektimit të ligjeve, udhëzimeve dhe masave për mbrojtjen nga pandemia Covid-19, të jeni më të kujdesshëm që buxhetin e shkollave që e keni ta shpenzoni me kohë në mënyrë që ato mjete financiare të mos shkojnë në deficit, por t’i bëni kërkesat me kohë në mënyrë që të kryeni punë me ato mjete financiare në shkollën tuaj”, ka thënë kryetari Latifi.

Nga ana e tyre drejtorët e shkollave thanë se do ta vazhdojnë bashkëpunimin me organet komunale dhe kryetarin si zyrtar kryesor administrativ.



Institucionet Shëndetësore në Mitrovicë, të përkushtuara për menaxhimin e pandemisë



MITROVICË, 18 JANAR - Drejtori për Shëndetësi në Komunën e Mitrovicës, Fahri Shabani, ka zhvilluar takime me drejtoreshën e Qendrës Rajonale të Shëndetësisë Publike në Mitrovicë, dr. Teuta Fejza, me u.d të drejtorit ekzekutiv të Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës, dr. Luljeta Zhubi, si dhe drejtorin e QKMF-së, dr. Fevzi Sylejmani.

Qëllimi i mbajtjes së këtyre takimeve ishte përgatitja dhe koordinimi i punëve dhe veprimit ndërinstitutional për menaxhimin sa më të mirë dhe efikas të situatës me pandeminë Covid-19 në komunën e Mitrovicës.

Nga këto takime është bërë me dije se institucionet shëndetësore në Mitrovicë janë të përgatitura dhe punëtorët shëndetësorë vazhdojnë të jenë të përkushtuar që edhe këtë valë të rritjes së numrit të rasteve të infektuar me Covid-19 ta

përballojnë më efikasitet. Sa i përket kujdesit parësor shëndetësor në kuadër të QKMF-së po rifunksionalizohet qendra kundër Covidit, me ç’rast pacientët me Covid-19 mund të marrin terapinë. “Po ashtu, është funksionale 24 orë linja telefonike nr. 194, ku pacientët me Covid-19 mund t’i marrin këshillat dhe udhëzimet e nevojshme nga ana e profesionistëve shëndetësorë. Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit në kuadër të QKMF-së është duke vazhduar me intensitet punën për vaksinim e popullatës me vaksinat kundër Covidit, por edhe me vaksinat kundër gripit sezonal”, ka njoftuar komuna e Mitrovicës. Drejtoria Komunale për Shëndetësi u ka bërë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë të kenë kujdes për respektimin e masave për parandalimin e Covidit si dhe të vaksinohen me vaksinat kundër Covidit.

Komuna e Kamenicës, qytetarëve: Vaksinoheni kundër Covidit

KAMENICË, 18 JANAR - Kohët e fundit numri i personave të prekur me Covid-19 është duke shënuar rritje. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka njoftuar

se gjatë 24 orëve të fundit në nivel vendi 720 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19, ndërsa në komunën e Kamenicës deri më tani janë 18 raste

pozitive. Kjo komunë u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër Covidit. “Duke parë këtë situatë u bëjmë thirrje që të vaksinoheni në mënyrë që

të mbronni dhe të tjerët nga Covid-19. Ju lutem respektojini rregullat e Institutit! Ruajeni veten dhe të tjerët!”, ka njoftuar komuna e Kamenicës.



Ambasadori i ri i ShBA-së premton mbështetje për sektorin e shëndetësisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka prituri të martën në takim ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier, me ç'rast e ka uruar për fillimin e misionit të tij në Kosovë dhe ka konfirmuar miqësinë e palëkundur mes dy shteteve.

Hovenier ka theksuar bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve, duke theksuar se emërimi i Latifit ministër i Shëndetësisë ka forcuar besimin e të gjithëve se Qeveria e Republikës së Kosovës po i kushton vëmendje të fuqishme këtij sektori shumë të rëndësishëm.

Ambasadori Hovenier ka vlerësuar mbështetjen e ShBA-së në fushatën e vaksinimit kundër Covid-19 dhe përmirësimin e

shërbimeve shëndetësore edhe përmes bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Hovenier ka ritheksuar se ShBA-ja edhe në të ardhmen do t'i ofrojë mbështetje Kosovës për arritjen e qëllimeve të saj drejt përmirësimit të kujdesit shëndetësor.

Ministri Latifi ka informuar ambasadorin rreth situatës me Covid-19 dhe ka theksuar se vendi ynë tani ka sasi të mjaftueshme të vaksinave për të gjithë qytetarët, kurse sistemi shëndetësor është përgatitur për reagim adekuat në rast të rritjes së mëtutjeshme të numrit të të infektuarve dhe spitalizimeve nga Covid-19.

Ministri Latifi ka treguar edhe për planin konkret të Ministrisë së Shëndetësisë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore të gjitha komunitetet në Kosovë edhe përmes aplikimit të telemjekësisë.



Kosova regjistron një viktimë dhe 720 raste të reja me Covid

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të martën janë regjistruar 720 raste të reja me Covid-19 pas testimit të 4 785 mostrave. Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 15.04 për qind. Në 24 orët e fundit është regjistruar një viktimë.

Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar se edhe 159 persona janë shëruar derisa 5 678 persona janë ende aktivë me koronavirus. Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet e Kosovës kanë regjistruar mbi 163 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2 995 persona kanë vdekur.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion doza të vaksinës.

Qytetarët në Kosovë mund të marrin vakcina të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca". Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre



muajve të marrjes së dozës së dytë. Bazuar në raportet e datës 18 janar nga klinikat Covid-19 në QKUK dhe në spitalet e përgjithshme, në trajtim mjekësor janë 81 pacientë nga Covid-19.

51 prej tyre të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 30 të tjerë post-Covid-19.

Me oksigjenoterapi janë 42

pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive një pacient.

Komisioni këshillëdhënës për masat kundër Covid-19 ka mbajtur një ditë më parë takim në Ministri të Shëndetësisë, ku ka diskutuar për situatën epidemiologjike në vend dhe për shqyrtimin e masave kundër

Covidit që janë në fuqi. Në këtë takim është theksuar nevoja e respektimit të plotë të masave të ndërmara më parë përmes mbikëqyrjes së zbatimit të tyre nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërkohë që popullatës i është bërë thirrje që të vaksinohet plotësisht, përfshirë edhe marrjen e dozës përforcuese të vaksinës

kundër Covid-19.

Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Omicroni po shton intensitetin çdo ditë dhe është varianti dominues në qarkullim.

IKShPK-ja ka bërë me dije se është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik.

"Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë në ditët në vazhdim, andaj IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim, ndërsa u rekomandojmë institucioneve përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar ky institut.

Deputeti Elmi Reçica takon në Zvicër veprimtarin Sali Bislimi

Prishtinë, 18 janar - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Elmi Reçica, njëherësh edhe udhëheqës i Departamentit të Diasporës nga PDK, ka filluar një vizitë zyrtare në Zvicër. Ai gjatë kësaj vizite ka takuar edhe

veprimtarin Sali Bislimi, drejtor i OJQ "Zëri Perëndimor i Kosovës" dhe drejtor i Zyrës Ligjore First-consulting.ch në Bern dhe Delémont të Zvicrës.

Reçica dhe Bislimi kanë diskutuar për zhvillimet në Kosovë dhe për jetën e bashkatdhetarëve në Zvicër.

"Qytetarët tanë në diasporë çdo ditë po integrohen më shumë në vendet më demokratike perëndimore, duke u arsimuar në shkollat më prestigjioze, duke hapur biznese të suksesshme të cilat kanë potencial të veprojnë edhe në Kosovë", ka thënë Reçica.



Oda e Hotelierisë dhe Turizmit po merr pjesë në panairin e organizuar në Antali

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 JANAR - Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, e përfaqësuar nga më shumë se 60 subjekte hoteliere, po merr pjesë në "Panairin Ndërkombëtar të Pajisjeve të Industrisë së Hotelierisë" i cili po organizohet nga Qendra e Panairëve dhe Kongreseve (ANFAS) në Antali, e që bashkon këtë sektor me tregjet botërore nga Antalia me përvojën e saj prej më shumë se një çerek shekulli. Ky panair që ka rëndësi shumë të madhe për promovimin e resurseve hoteliere të vendeve të ndryshme, organizohet për të 32-n herë me radhë.

Këtë vit kjo ngjarje e rëndësishme ka filluar të martën për të vazhduar me aktivitete të shumta deri më 21 janar, në Anfas International Expo dhe Qendrën e Kongreseve në Antalia, duke u angazhuar të

bashkojë më shumë se 450 ekspozues me mbi 45 000 vizitorë profesionistë nga 81 provinca në Turqi dhe mbi 45 shtete të huaja. "Qëllimi kryesor i këtij panairi është promovimi i hotelierisë dhe pajisjeve industriale të saj duke i kushtuar rëndësi edhe promovimit të mjeteve të punës të cilat përdoren në këtë industri. Çdo vit ky panair tërheq numër shumë të madh vizitorësh, si ishte rasti në vitin 2019 që në këtë organizim kanë marrë pjesë më shumë se 44 625 vizitorë nga e tërë bota", ka njoftuar Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës.

Përfaqësuesit e OHTK-së, të kryesuar nga kryetari Hysen Sogojeva, po marrin pjesë në këtë panair, duke e parë si mundësi të artë për promovimin e odës dhe subjekteve të saj anëtare, me theks të veçantë për promovimin e sektorit të hotelierisë dhe gastronomisë të



Kosovës. "Ky panair është rrugë shumë e mirë që do të lejojë t'i gjejë të gjitha mundësitë për arritjen e objektivave si organizatë, por edhe si shtet", ka vlerësuar kryetari i Odës së

Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, Hysen Sogojeva. Ai ka bërë me dije se gjatë kësaj vizite zyrtare OHTK do të zhvillojë takime të rëndësishme dhe do të nënshkruajë marrëveshje

bashkëpunimi me subjekte hoteliere dhe me organizata simotra në Turqi duke vënë theksin te marrëveshja e bashkëpunimit që do të nënshkruhet me ANFAS.

Zyra Kombëtare e Auditimit fillon zbatimin e planit të trajnimeve të brendshme

PRISHTINË, 18 JANAR - Me qëllim të zhvillimit profesional dhe avancimit të mëtutjeshëm të njohurive, punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) gjatë muajit janar do ta zbatojnë planin e trajnimeve të brendshme. "Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve profesionale është prioritet i Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe sipas planit vjetor të trajnimeve dhe zhvillimit profesional adresohen nevojat dhe kërkesat e stafit për zhvillim. Aktualisht është duke u mbajtur trajnimi për shkrimin e raporteve dhe përdorimin e gjuhës së thjeshtë. Ky trajnim është organizuar në kuadër të projektit të bashkëpunimit bilateral me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë sipas projektit 'Bashkëpunimi për Zhvillim Institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023'. Trajnimi ofrohet nga ekspertët dhe



kolegët nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë", ka njoftuar Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Po kjo zyrë ka theksuar se në

kuadër të planit të trajnimeve për muajin janar do të mbahet edhe trajnimi i brendshëm me temën "Puna në sistemin SITA, problemet kryesore teknike, si të

shfrytëzohen manualet dhe udhëzimet të cilat janë vendosur në SITA (teknika të shpejta dhe efikase të mësimin)".

ZKA-ja ka njoftuar se një trajnim


tjetër që do të mbahet gjatë këtij muaji është edhe "Qasja e auditimit në auditimin e pasurive" si dhe trajnimi "Përdorimi i procedurave analitike substanciale". "Gjithashtu deri në fund të muajit janar do të mbahet edhe trajnimi për Ligjin nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve si dhe ai për aktet nënligjore të ZKA-së. Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, institucionet e auditimit duhet të promovojnë zhvillim të vazhdueshëm profesional i cili u kontribuon auditorëve, ekipit dhe përsosmërisë së organizatës. Në përputhje me këto kërkesa, ZKA-ja është e përkushtuar që të sigurojë se stafi i saj ka kompetenca profesionale dhe ka mbështetjen e kolegëve dhe menaxhmentit për ta kryer punën si duhet", ka njoftuar ZKA-ja.

Gjermania jep 12.65 milionë euro për ngrohjen qendrore të Termokosit me energji solare

PRISHTINË, 18 JANAR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar se Qeveria e Gjermanisë ka zotuar edhe 12.65 milionë euro shtesë për ngrohjen qendrore me energji solare. Murati në profilin e vet në "Facebook" ka treguar se ky projekt do të fillojë shumë shpejt. "Si rezultat i thellimit të bashkëpunimit të mirë, Qeveria

e Gjermanisë ka zotuar edhe 12.65 milionë euro shtesë për projektin e ngrohjes qendrore me energji solare që pritet të fillojë shumë shpejt. Këto mjete do të jenë grant dhe e sjellin në mbi 26 milionë euro gjithsej kontributin e Qeverisë së Gjermanisë në formë granti për këtë projekt. Projekti në fjalë parasheh rritjen e kapacitetit për ngrohje qendrore dhe

mundëson zgjerimin e mëtejme të rjetit të Termokosit, duke mundësuar eficiencë shtesë e shfrytëzim të burimeve të ripërtërishme. Kjo, po ashtu, nënkupton që më shumë familje të kenë ngrohje me çmim të përbalueshëm, duke rezultuar kështu edhe në zvogëlim të konsumit të energjisë elektrike që përdoret për ngrohje", ka thënë ministri Murati.



Çfarë e bëri Napoleon Bonapartin, aq të suksesshëm?



Historia e Napoleon Bonapartit është e pabesueshme. I lindur në një familje modeste fisnikësh në ishullin e Korsikës, ai i ngjiti shpejt shkallët e karrierës për t'u bërë perandori i Francës. Në kulmin e mbretërimit të tij, Napoleoni kishte nën kontroll një pjesë të madhe të Evropës.

Por ai ka pasur një ndikim thelbësor në Francë dhe në të gjithë Evropën, si për shembull përmes Kodit Napoleonik dhe taktikave të tij ushtarake revolucionare. Napoleoni konsiderohet nga shumë studiues si një nga komandantët më të mëdhenj ushtarakë në histori, dhe në përgjithësi, një nga udhëheqësit më të mëdhenj gjithashtu.

Por sukcesi i Napoleonit nuk erdhi vetëm nga gjenialiteti i tij ushtarak. Dhe ndoshta më e rëndësishmja, ai kishte një sërë aftësish dhe tiparësh drejtuese mbresëlënëse, të cilat e ndihmuan të arrinte qëllimet, të mposhte armiqtë, dhe ta shndërronte Francën në një fuqi të vërtetë botërore. Ja cilat janë disa nga ato aftësi dhe tipare:

Zguarsia e madhe

Napoleoni ishte shumë i zgjuar. Por përveç kësaj, ai kishte edhe aftësi të tjera mbresëlënëse njohëse. Për shembull, kishte një kujtesë shumë të fortë. Edhe në mesin e betejës, ishte në gjendje të

kujtonte çdo detaj dhe statistikë rreth ushtrisë së tij.

Gjatë fushatës ushtarake të vitit 1805, një nga komandantët e tij e harroi vendndodhjen e divizionit të tij. Ndaj me disa të tjerë filloi të shihte hartën për të gjetur se ku ishin. Ndërkohë Napoleoni i hodhi një sy të shpejtë hartës dhe u tha atyre vendndodhjen, ku do të ishin për 3 ditët e ardhshme, si dhe logjistikën e secilës prej njësive brenda divizionit.

Ai ishte shumë i aftë në kryerjen e shumë detyrave. Napoleoni u diktonte njëra pas tjetres letra sekretarëve të tij, shpesh mbi një sërë temash të ndryshme, pa pasur nevojë të ndalej për ndonjë moment dhe të mendonte. Kështu vetëm gjatë 3 muajve të parë të vitit 1807, Napoleoni dërgoi 1715 letra, apo mesatarisht 19 letra në ditë.

Ato kishin të bënin me qëllimet ushtarake, personale, financiare, diplomatike dhe administrative. Edhe gjatë fushatave ushtarake, Napoleoni ishte në gjendje t'i linte mënjanë streset e tij dhe të diskutonte (me një përqendrim ekstrem) çështje të tjera që do të lindnin aty për aty.

Dija është pushtet

Napoleoni nuk ishte asnjëherë dembel. Pavarësisht inteligjencës së tij të jashtëzakonshme, ai kërkonte gjithmonë të përmirësonte veten, dhe të fitonte

më shumë njohuri në përgatitje për veprimin e ardhshëm. Për shembull, përpara një fushate ushtarake, Napoleoni do të studionte me imtësi zonën që do të pushtonte apo vepronte.

Ai do të gjente gjithnjë kohë të mësonte rreth kulturës, gjeografisë dhe historisë së rajonit, madje edhe duke studiuar fushatat e kaluara ushtarake në të njëjtën zonë, një mënyrë për të shmangur gabimet që kishin bërë udhëheqësit e mëparshëm. Prandaj, Napoleoni ka qenë gjithmonë një lexues i thekur.

Që nga rinia e tij, ai do të studionte shumë lëndë si shkencë, filozofia dhe sigurisht historia. Atij i pëlqente veçanërisht të lexonte klasikët, të studionte dhe lexonte mbi komandantët ushtarakë të famshëm të botës antike, si Aleksandri i Madh apo Jul Çezari. Po ashtu Napoleoni ishte një intervistues i aftë. Ai do t'i intervistonte personalisht ushtarët armiq të kapur rob, dhe nuk druhej asnjëherë të bënte pyetje të thella në mendime për të kuptuar më mirë situatat.

Çelësi është të qenit i përgatitur në çdo rast

Në rast se një ushtri nuk është e ushqyer apo e pajisur mirë, atëherë si mund t'i fitojë ajo betejat? Napoleoni e kuptonte shumë mirë këtë, dhe sigurohej gjithmonë që ushtria e tij të ishte e

përgatitur për çdo konflikt të ardhshëm. Në fakt, në një rast ai dërgoi 63 letra për këpucë dhe çizme për trupat e tij.

Mjeshtër i propagandës

Napoleoni ishte shumë i aftë në artin e propagandës. Ai dinte të përdorte opinionin popullor të asaj kohe për të fituar një mbështetje të gjerë për veten. Napoleoni e paraqiste veten si bërthama e Revolucionit Francez, duke deklaruar në mënyrë të famshme: "Unë jam Revolucionari". Ai e përdori atë si një justifikim për pushtimet që kreu si përpara publikut francez po ashtu edhe para trupave të tij. Ashtu si përpara pushtimit të Italisë, Napoleoni mbajti një fjalim para trupave të tij, duke i paraqitur ata si "çlirimtarë" që "përhapnin" ideat e ndritura të Revolucionit Francez. Këto shprehje ndihmuan në motivimin e ushtarëve të tij duke i bashkuar ata nën një kauzë apo besim të përbashkët të krijuar nga Revolucionari.

Sharmi i tij personal

Karizma e Napoleonit ishte mbresëlënëse. Ai ishte në gjendje të ngjallte besimin dhe besnikërinë e trupave të tij, ndaj shumica e ushtrisë ishte tërësisht e përkushtuar ndaj tij. Napoleoni e arriti këtë duke treguar të njëjtën besnikëri ndaj tyre, duke i

motivuar dhe duke u kujdesur për trupat e tij.

Përveç motivimit të tyre përmes fjalimeve, prania e vetë Napoleonit në fushën e betejës sillte një atmosferë fitoreje për ushtrinë franceze. Ushtarët e dinin se po luftonin për njeriun që e shndërroi vendin e tyre në një fuqi botërore. Po ashtu Napoleoni hante bashkë me ushtarët e tij, bisedonte me ta në kamp, vishej me veshjet tradicionale të gardës së tij perandorake, dhe ndonjëherë përfshihej edhe vetë në betejë.

Si për shembull duke ngarkuar topa në Lodi kundër Austrisë. Për më tepër, Napoleoni dinte se si të kujdesej për njerëzit e tij. Siç u përmend më lart në lidhje me furnizimet dhe këpucët, Napoleoni gjithmonë sigurohej që ushtria e tij të ishte e pajisur siç duhej, duke u kujdesur për mirëqenien e trupave.

Madje ai mësonte përmendësh emrat e ushtarëve, duke i thirrur ata në kamp. Gjithashtu, ai ishpërblente njerëzit e tij, duke krijuar çmimin e famshëm Legjioni i Nderit në vitin 1802. Napoleoni shkante shpesh tek një komandant, e pyeste se kush ishte ushtari më i guximshëm në divizionin e tij, i hiqte një distinktiv apo fjongo nga palltoja e tij dhe ia jepte ushtarit në fjalë. Ky akt kishte një efekt shumë domethënës në pjesën tjetër të ushtrisë. / History of Yesterday – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Prishtina vazhdon përgatitjet në Turqi, konfirmon ndarjen me Bekteshin

Skuadra më e trofeshme në Kosovë, FC Prishtina, në Turqi është duke i mbushur "bateritë" për sezonin pranveror në BKT Superligë. Klubi kryeqytetas të martën ka njoftuar se mbrojtësi Leotrim Bekteshi edhe zyrtarisht nuk do të jetë pjesë e saj në sezonin pranveror. "Stafi i FC Prishtina e falënderon nga zemra Leon për mundin dhe djersën e derdhur për fanellën kryeqytetase", thuhet në njoftimin e FC Prishtina



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 18 JANAR - FC Prishtina ka arritur në Antalia të Turqisë. Është akomoduar në hotelin "Titanic" në Lara derisa të martën në mëngjes e ka kryer edhe stërvitjen e parë nën drejtimin e stafit teknik të udhëhequr nga trajneri Abdulah Ibrahimović. Futbollistët kanë kryer ushtrime të fituesit, ndërsa pasdite janë stërvitjet në fushat e kompleksit të hotelit. Klubi prishtinas ka njoftuar se gjendja e të gjithë futbollistëve është e mirë. Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll ka njoftuar nëpërmjet faqes zyrtare se ka ndarë rrugët me

njërin prej lojtarëve më të mirë në vitet e fundit, Leotrim Bekteshi. Qendërmbrojtësi nuk do të jetë pjesë e asnjë skuadre në Kosovë, pasi ka vendosur që jetën ta bëjë së bashku me familjen e ngushtë në Norvegji. Skuadra më e madhe në vend e ka falënderuar mbrojtësin Bekteshi për kontributin e madh të dhënë përgjatë tri vjetëve e gjysmë. "Faleminderit Leo! Leotrim Bekteshi nuk është më pjesë e Prishtinës. Bekteshi është një ndër futbollistët që ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në skuadrën më të madhe në vitet e fundit. Ai me Prishtinën në tri vjet e gjysmë sa ishte pjesë i ka regjistruar 150 paraqitje derisa e ka fituar titullin kampion, Kupën e Kosovës

si dhe Superkupën. Bekteshi, i cili në shumë ndeshje e ka bartur edhe shiritin e kapitenit, ka edhe trofe individuale si futbollist i Prishtinës derisa është përfshirë edhe në formacionin e vitit nga Federata e Futbollit e Kosovës për edicionin e fundit. Bekteshi ka vendosur ta vazhdojë jetën së bashku me familjen e ngushtë në Norvegji. Stafi i FC Prishtina e falënderon nga zemra Leon për mundin dhe djersën e derdhur për fanellën kryeqytetase", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Skuadra "bardhekaltër" sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e pestë me 24 pikë të grumbulluara. Prej 18 ndeshjeve ka regjistruar 6 fitore, 6 barazime dhe po aq humbje.

SHKURT

Më 22 janar mbahet Asambleja Ballkanike e Volejbollit

Presidenti i Federatës së Volejbollit të Kosovës, Bahri Gjinovci, i shoqëruar nga nënkryetarja Mimoza Shkodra dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikçi, do të marrin pjesë në asambleenë e përvitshme ballkanike të volejbollit, ku do të vendoset për aktivitetet e vitit 2022, datat dhe organizatorët. Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja në këtë asamble, pasi presidentët dhe përfaqësuesit e federatave ballkanike votojnë për vendimet që do të diskutohen sipas pikave të agjendës që janë caktuar paraprakisht. Asambleja mbahet në Shkup dhe është e 23-ta rresht e organizuar nga BVA. Të pranishëm do të jenë edhe presidenti i Konfederatës Evropiane të Volejbollit (CEV), Aleksandar Boriqiq, zëvendës-presidenti Renato Arena dhe drejtori për Zhvillim, Ozkan Mutlugil. Veç këtyre janë konfirmuar si pjesëmarrës edhe presidentët e federatave të Kroacisë dhe të Sllovenisë, Ante Baković, respektivisht Metod Ropret.

Albin Tahiri dhe Kiana Kryeziu përfaqësojnë Kosovën në LOD Pekini 2022

Albin Tahiri dhe Kiana Kryeziu do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e 24-ta Olimpikë Dimërore Pekini 2022. Të dy skitarët e skijimit alpin kanë përbushur normat olimpikë në ciklin kualifikues, i cili u mbyll të dielën. Tahiri, 32-vjeçar, ka fituar katër norma olimpikë në disiplinën e sllallomit, sllallomit të madh, kombinimit alpin dhe lëshimit. Kryeziu, 17-vjeçare, është kualifikuar në disiplinën e sllallomit të madh. Kiana është bërë sportistja e parë femër që do ta përfaqësojë vendin tonë në një olimpiadë dimërore. Dy norma olimpikë i kishte fituar edhe Arbi Pupovci, në disiplinën e sllallomit dhe sllallomit të madh, por rregullat e Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë parashohin që shtetet të cilat nuk kanë sportistë në mesin e 30 më të mirëve në këtë sport, kualifikohen me vetëm një sportist për gjini. Ekipi Olimpik i Kosovës ka debutuar në Lojërat Olimpikë Dimërore PyeongChang 2018, me sportistin e vetëm Albin Tahiri, i cili kishte garuar në pesë disiplinën e skijimit alpin. Kosova është në mesin e 90 shteteve pjesëmarrëse në Olimpiadën e Pekinit, e cila do të mbahet në Pekin të Kinës prej 4 deri më 20 shkurt 2021.

Trajnerët e Kosovës në basketboll marrin trajnime në Turqi

Katër trajnerë nga Kosova kanë qenë në Turqi të cilët ishin pjesë e një trajnimit për avancimin e gjeneratave të reja në basketboll program që mbështetet nga FIBA YDF (Youth Development Fund). Trajnerë pjesëmarrës nga Kosova ishin Kimete Haliti, Hasan Bytyqi, Dion Pllana dhe Egzon Uka. "Kjo është mundësuar nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK). Ata ishin mysafirë të Federatës së Basketbollit të Turqisë ku, përveç trajnimeve, kanë përcjellë stërvitjet dhe ndeshjet e klubeve turke që marrin pjesë në Euroligë, si Fenerbahçe, Anadolu Efes dhe Darusafakas", thuhet në njoftimin e tyre. Kjo ishte një përvojë e mirëseardhur për trajnerët e Kosovës të cilët do të punojnë me gjeneratën e reja. "Federata e Basketbollit të Kosovës tash e gjashtë vjet është pjesë e projektit të FIBA-s për Zhvillim të Gjeneratave të Reja, por në vitin 2019 projekti ka filluar të implementohet edhe për vajza, gjë që shërben në dobi të zhvillimit të basketbollit në konkurrencën e femrave". Në këtë projekt janë të përfshirë djem dhe vajza të moshës 13 vjeç (të lindur më 2007 dhe 2008) dhe trajnerë të rinj e të talentuar.

Kuka: Nora Gjakova punoi 19 vjet me përkushtim për medaljen e artë olimpikë

Pejë, 18 janar - Trajneri Driton Kuka ka thënë se xhudistja Nora Gjakova nuk është ndalur për 19 vjet me radhë për t'i arritur sukseset kulmore në xhudo. "Nora Gjakova e nisi xhudon diku në vitin 2002. Plot 19 vjet

punoi me përkushtim. Nuk kishte medalje Botërore as Olimpikë deri më 2021, por pandemia sikur ia rriti përkushtimin drejt cakut. Punoi shumë vitet e fundit dhe në Budapest në qershor 2021 fitoi

medaljen e saj të parë Botërore, por ishte e qetë pas fitores së medaljes në Botëror, pa emocione. Kishte qëllim. E donte medaljen Olimpikë. Dhe në Lojëra Olimpikë kulmoi me formën e saj. Ashtu ishte vizatuar

rruga e formës dhe ashtu ndodhi. Fitoi titullin më të madh që mund të fitonte të artën olimpikë. Pas Majlindës, Distrias, erdhi edhe e arta e Norës. Tri copa të arta për Kosovën nga xhudo. Sporti i xhudos, brendi



shtetit tonë të ri", ka shkruar Kuka në profilin e vet në "Facebook".

Miqësorja Spanjë - Shqipëri do të luhet në Barcelonë nga ora 19:00

Tiranë, 18 janar - Është konfirmuar tashmë ora dhe vendi ku do të luhet miqësorja e 26 marsit, Spanjë - Shqipëri. Sipas marrëveshjes mes dy federatave, ky takim do të luhet në stadiumin "RCDE", që është shtëpia e skuadrës së Espanyolit në

Barcelonë, duke filluar nga ora 19:00. Siç dihet tashmë, kjo do të jetë ndeshja e parë miqësore mes këtyre dy përfaqësuesve, të cilat deri më tani kanë luajtur ndaj njëra-tjetres shtatë sfida, të gjitha të vlefshme për kualifikueset e kampionateve evropiane dhe

botërore. Ndërkaq, më 29 mars 2022 Shqipëria do të zhvillojë një tjetër miqësore ndaj Gjeorgjisë. Kjo ndeshje do të zhvillohet në Shqipëri sipas marrëveshjes së arritur mes dy federatave, ndërkohë që mbeten ende për t'u përcaktuar stadiumi që do të

presë sfidën dhe orën kur do të luhet. Këto miqësore zhvillohen në kuadër të përgatitjes së kombëtares shqiptare për ndeshjet e grupit në Ligën e Kombeve, që nisin në muajin qershor. Trajneri Edoardo Reja do ta ketë mundësinë t'i testojë



lojtarët dhe ekipi kuqezi pas thuajse katër muajsh nga ndeshja e fundit.

Bajrami kërkohet nga Juventusit dhe Milani

TORINO, 18 JANAR - Nedim Bajrami është kthyer në një nga emrat më të përfolur në afatin kalimtar të janarit në Itali, me klubet e Serisë A që shohin te 22-vjeçari i përfaqësueses shqiptare një nga lojtarët me të ardhme të sigurt në elitën e futbollit në këtë vend. Futbollisti 22-vjeçar ka shënuar 5 gola dhe ka dhënë 3 asistime në 20 ndeshjet e luajtura deri tani në këtë sezon në Serinë A me Empolin, duke u kthyer shpejt në një nga lojtarët e rinj më interesant. Prej ditësh përflitet për negociatat me Sassuolon që është gati të paguajë 10 milionë euro për kartonin e tij, ndërsa është raportuar se edhe Juventusit po monitoronte futbollistin e përfaqësueses shqiptare. E përditshmjia italiane "Tuttosport" ka raportuar se mes klubeve që po monitorojnë lojtarin



tani bën pjesë edhe Milani, ndaj të cilit ai shënoi një nga golat në elitën e futbollit italian në këtë sezon. Kuqezinjtë janë gjithmonë në kërkim të lojtarëve të rinj premtues dhe duket se edhe Maldini po sheh më vëmendje Bajramin. Nuk ka

ende një lëvizje konkrete, si ajo e Sassuolos, por rritja e numrit të pretendentëve për lojtarin, e sidomos me emra si Juventusit e Milani, tregon qartësisht vlerat që ka fantazisti i përfaqësueses shqiptare.

Memphisi shkatërron edhe Chicagon

MEMPHIS, 18 JANAR - Kampionët e Milwaukee Bucksit u mundën me rezultat 121-114 nga Atlanta, duke zbritur në vendin e pestë në renditje në Konferencën e Lindjes. Middleton e Antetokounmpo realizuan 61 pikë së bashku, por s'mjaftuan për të fituar. Gjashtë lojtarë të Atlantës realizuan mbi 10 pikë, me Youngun protagonist me 30 pikë e 11 asistime. Brooklyni u mposht me rezultat 114-107 nga Clevelandi, duke humbur terren me kreun. Irvingu



(27) dhe Hardeni (22) u përpoqën ta mbajnë në lojën Netsin, por pa sukses. Për Cavaliersin u dallua Garlandi me 22 pikë e 12 asistime. Vijnë të shkëlqejë në kampionat Memphisit, që mposhti me rezultat 119-106 Chicagon, ekipin që kryeson renditjen në Lindje. Bane e Moranti realizuan nga 25 pikë secili për Memphisin. Fiton edhe skuadra e Lakersit, që pas tri humbësh mposhti 101-95 Utah

Jazzin. Për lakersat u dallua LeBron Jamesi me 25 pikë. Mbrëmje magjike për Bookerin, i cili realizoi 48 pikë në fitoren 121-107 të Phoenixit ndaj San Antonios. Skuadra e Phoenixit kryeson renditjen në perëndim. Fitojnë edhe clippersat, që mundën 139-133 Indianan (Batum 32 pikë), ndërsa Miami mposhti me rezultat 104-99 rivalët e Torontos (Herro 23 pikë).

REZULTATET

BOSTON - NEW Orleans	104-92
New York - Charlotte	87-97
Washington - Philadelphia	117-98
Cleveland - Brooklyn	114-107
Clippers - Indiana	139-133
Memphis - Chicago	119-106
Atlanta - Milwaukee	121-114
Orlando - Portland	88-98
Miami - Toronto	104-99
Dallas - Oklahoma	104-102
San Antonio - Phoenix	107-121
Lakers - Utah Jazz	101-95

SHKURT

Newcastle ofron 40 milionë euro për Hazardin

Skuadra e Newcastle Unitedit është e interesuar për transferimin e Eden Hazardit nga Real Madridi. Mediumi "El Nacional" raporton se klubi anglez i ofron 40 milionë euro për futbollistin belg. Por, Reali duket se e ka refuzuar këtë ofertë. "Los Blancos" e kishte blerë lojtarin për 115 milionë euro nga Chelsea dhe nuk dëshiron të humbasë aq shumë para. "Mbretërit e Spanjës" do ta shisinin 31-vjeçarin vetëm për një ofertë prej më shumë se 50 milionë eurosh. Gjithashtu, duket se edhe përfaqësuesi belg nuk është i interesuar për t'iu bashkuar ekipit bardhezi. Më shumë ai do ta pëlqente rikthimin në Chelsea, ku e kishte arritur kulmin e karrierës.

Wolff: E vështirë ta pranoj humbjen, ja kur do të takohem me Hamiltonin

Toto Wolff, drejtori sportiv i Mercedesit, u shpreh se ka kohë që nuk e ka takuar 7 herë kampionin e botës në Formula 1, britanikun Lewis Hamilton. Ky i fundit ka ende dy vjet kontratë me makinën gjermane, por pas zhgënjimit në garën e fundit në Abu Dhabi, ka mbyllur çdo kontakt në rrjetet sociale dhe mund të tërhiqet nga sporti. Gjithsesi, Wolff shpreson t'i rivendosë urat e komunikimit me pilotin britanik: "Do të takohemi në shkurt, por jo për të pirë tekila. Kemi pirë shumë në pistën e Yas Marinas, pas zhgënjimit në garën e fundit. Nuk ka rëndësi se çfarë pengese ka përpara Lewisi, pasi është pista ajo që flet më së miri për punën e tij. Për atë do të jetë i vështirë të pranojë gjithçka ndodhi në pistë në garën e fundit, për sa kohë nuk dimë diferencën mes të drejtës dhe të gabuarës. Ka nevojë për kohë", ka shtuar Wolff.

Nëse Reali e transferon Haalandin, Benzema shkon në PSG

Karim Benzema është shumë i dashur për fansat e Real Madridit, por nuk i pëlqen fakti që Florentino Perez ka vendosur të transferojë në skuadër Erling Haaland. Gazeta spanjolle "El Nacional" raportoi se në moshën 34-vjeçare Benzema nuk dëshiron të heqë dorë nga futbollit dhe në rast se skuadra madrilene nënshkruan me norvegjezin, ai mund të largohet nga Reali dhe të shkojë te PSG-ja. Mësohet se bisedimet mes parisienëve dhe ish-sulmuesit të Olympique Lyonnais kanë nisur prej kohësh dhe marrëveshja është e dëshiruar nga të dyja palët. Benzema ka një kontratë me Realin deri në vitin 2023.

Liverpooli, favorit për transferimin e Sanchesit

Skuadra e Liverpoolit shihet si favorite kryesore për ta kompletuar transferimin e mesfushorit të Lilles, Renato Sanches. Ish-mesfushori Sanches që ka qenë i lidhur me kalimin te Wolves në gusht, tani pëlqehet nga disa klube evropiane. Arsenalit dhe Barcelona raportohet se janë duke monitoruar situatën me Lille që është e pajtimit t'i ndajë rrugët me lojtarin që ka më pak se 18 muaj të mbetur në kontratë. Sipas "El Nacional", Liverpooli është në bisedime të avancuara për transferimin e 24-vjeçarit. Barcelona raportohet se nuk ka para për ta finalizuar nënshkrimin me portugezin, duke lejuar "Reds"-in të jetë favoriti kryesor. Ndërkohë, Sanchesit këtë edicion ka bërë 13 paraqitje si titullar dhe tre si inkuadruar në të gjitha garat.

Tucheli paralajmëron Lukakun: Çdo lojtar duhet të vihet në shërbim të skuadrës

Trajneri Thomas Tuchel ka paralajmëruar Romelu Lukakun në konferencën për shtyp. Ai ka thënë se sulmuesi belg duhet ta kuptojë se në skuadrën e Chelseat secili

lojtar duhet të vihet në shërbim të skuadrës. "Mendoj se po bëjmë gjithçka është e mundur për ta ndihmuar, por nuk do të doja që gjithçka të reduktohej te

një lojtar i vetëm, edhe pse flasim për një lojtar kyç dhe të gjithë duam të jetë vendimtar. Megjithatë, mendoj se është një gabim që e gjithë skuadra të punojë për

një lojtar. Futbollit është një lojë skuadre, për mua nuk ekziston që 10 ose 11 lojtarë t'i shërbejnë njërit", ka thënë Tuchel. "Te Chelsea nuk funksionon kështu. Në

futboll nuk funksionon kështu. Çdo lojtar duhet të vihet në shërbim të skuadrës. Ky është koncepti dhe kështu do të jetë gjithmonë", ka shtuar Lukaku.



Shkolla e Mesme e Profesionale "Ymer Prizreni" Prizren

Kosovë 20000 Prizren rr.Bajram Curri p.n
Nr.tel.038/20035377
e-mail:mgavazaj@hotmail.com



Nr.protokoli-28/2022

Në bazë të Rregullorës nr.01/2017,datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, Drejtoresha e Shkollës së Mesme Ekonomike "Ymer Prizreni" në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

KONKURS

EKONOMI

- 1.Kontabilitet e tatime..... 1 paralel 24 nxënës
- 2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 24 nxënës

HOTELERI

- 1.Asistent i mikëpritjes hoteliere.....1 paralel 24 nxënës

TEKNOLOGJI USHQIMORE

- 1.Teknologji ushqimore.....1 paralele 24 nxënës

ADMINISTRATË

- 1.Administrim dhe shërbime të zyrës..... 1 paralel 24 nxënës

Kushtet:

Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak,certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).

Pagesa bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa,taksa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
2. Praktika profesionale 50 €
3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
4. Lënda me gojë 8€
5. Për diplomë(përfundimi i shkollimit): 50€
6. Provime diferenciale 10€

Vijueshmëria në mësim

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrohen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.

Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Metalurgu" Sh.p.k. Mitrovicë., në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën për grumbullimin, mbledhjen, magazinimin, çmontimin e automjeteve mbeturine dhe komponentëve të tyre, mbeturinave metalike dhe jo metalike, ndarja, klasifikimi dhe përpunimi me nr.KEM:

170401;170402;170403;170404;170405;170406;170407;191201;191202;191203;191204;191002.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.02.2022 në ora 10:00, në Shupkocv, në restorantin e Stacionit të Karburanteve "SHELL" pa numer Shupkocv, pranë rrugës magjistrale: Mitrovicë -Vushtrri-Prishtinë në anën e djathtë, në kilometrin e 3 nga Mitrovica, apo në anën e kundërt nga Hoteli Pallas -Shupkocv do të organizohet debat publik nga Kompania "Metalurgu" Sh.p.k. Mitrovicë., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën për grumbullimin, mbledhjen, magazinimin, çmontimin e automjeteve mbeturine dhe komponentëve të tyre, mbeturinave metalike dhe jo metalike, ndarja, klasifikimi dhe përpunimi me nr.KEM:

170401;170402;170403;170404;170405;170406;170407;191201;191202;191203;191204;191002.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM Join Zoom Meeting

<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhS3IKdEVTV1F0NTFvZz09>

Meeting ID: 966 277 1284

Passcode: 112233

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Metalurgu" Sh.p.k. Mitrovicë.për bazën për prodhimin e betonit në Fshati i Vjetër, Ferizaj.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojme të gjithë klientet se kompania GREYDER-KS.shpk me seli në Prizren ka marrë vendim të shuaj aktivitetin e biznesit me NUI 810044248 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientet që kanë raport Kreditor – Debitor në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazete.

OBAVSTENJE

Objavjestavamo sve kliente da firma GREYDER-KS.doo u Prizrenu doneo odluku da ugasi biznis po broju NUI 810044248 i ujedno imenovao Likvidatora o sporvpdjenju postupka likfidacije.Obevastaju sa svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi da se jave u roku 30 dana od dana objavljivanja u novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that companz GREYDER-ks.llc in Prizren decided to close the activity the business with NUI NUI 810044248 .The Company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process.All clients who have a credit – debit account relation in this company are kindlz request to show up within 30 days starting from the date of newspaper announcmenet publication.

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se akcionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Champion Construction Sh.p.k. me numër unik identifikues: 811256529 me seli në Fushë Kosovë, Adresa: Nëna Terezë Nr.222 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Korab Bajgora me ID: 1174268319 me vendbanim në Lupç i Poshtëm, Komuna: Podujevë me tel:044/372-625 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të përealizuara dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

